

Prof. Dr. Sejjid Husejn Nasr

## Ç'ËSHTË SHKENCA ISLAME?

*“E Tij është çdo gjë që ekziston në qiej e në tokë dhe çdo gjë që gjendet në mes tyre, edhe ç’ka në dhe” (Kur’ani, Taha, 6).*

Ekziston një trup i një diturie të organizuar e cila mund të quhet shkencë islame dhe e cila është islame jo pse është kultivuar nga ana e muslimanëve, por, për më tepër, sepse ajo përputhet me parimet, normat dhe qëllimet e Shpalljes islame dhe pse organikisht është e lidhur me të. Asnjë shkencë nuk mund të quhet islame vetëm pse etimologjikisht rrjedh prej fjalës *sciencia*, e cila është ekuivalente e fjalës *el -‘ilm*, ose nga fakti se një musliman, pa marrë parasysh devotshmërinë e tij, e zhvillon dhe i kontribuon asaj.<sup>1</sup> Shkenca islame buron nga Kur’ani dhe është e bazuar në doktrinën e Njëjesisë (Tewhidit – Besimit në një Zot të vetëm) e cila e përbën qendrën e Shpalljes Kur’anore. Ajo është zhvilluar brenda kornizës së të kuptuarit islam mbi universin, nga njëra anë dhe të shkencës, nga ana tjetër. Për më tepër se një milenium, shkencëtarët muslimanë e kanë zhvilluar këtë trup të shkencës duke u inspiruar nga traditat e mëhershme shkencore, mirëpo këtë gjithnjë e kanë bërë duke e integruar atë që e kishin adoptuar nga këto burime në botëkuptimin islam dhe kështu kanë krijuar një rëndësi ndër traditat më të njohura shkencore në botë. Pra, mu kjo është ajo tradita që e përbën atë të cilën ne e quajmë *shkencë islame*.

Për ta kuptuar natyrën e kësaj shkence, para së gjithash me rëndësi është që këtë ta ndajmë nga zbatimi i saj në formën e teknologjisë, po bile edhe nga implikimet e saj etike. Edhe pse këto zbatime kanë një rëndësi të veçantë, ato duhen shqyrtuar veç e veç kur të trajtohen implikimet e kuptimit të shkencave të ndryshme islame. Para së gjithash duhet të pyesim se ç’është natyra e kësaj shkence dhe ç’janë karakteristikat që duhet t’i bart një trup i këtyllë i diturisë që të mund të quhet shkencë islame?<sup>2</sup> Prandaj, vetëm pas

<sup>1</sup> Këtë temë e kemi shkoqitur në mjaft shkrime të tjera tonat, si p. sh. në *Science and Civilization in Islam*, Cambridge, (SHBA), 1968 dhe Kuala Lumpur, 1984; *Islamic Science-an Illustrated Study*, Londër, 1976 (së shpejti pritet të botohet edhe në gj. shqipe në përkthim të Mr. Ali Pajazitit); dhe *Islamic Science* në edicionin e S. Azzamit me titull *Islam and Contemporary Society*, Londër, 1982, f. 177-190.

<sup>2</sup> Meqë ne këtu e trajtojmë filozofinë e shkencës islame, *shkencës* ashtu siç kuptohet në kontekstin bashkëkohor, diskutimi ynë lidhur me veçoritë e shkencës islame do të jetë i kufizuar me shkencat natyrore dhe me matematikën.

shqyrtimit të kësaj pyetjeje mund t'i kthehemi botëkuptimit islam lidhur me zbatimin e shkencave në format e teknologjive të ndryshme dhe të implikimeve të tyre etike. Sado që kjo lënda e mëposhtme të jetë e rëndësishme, ajo nuk mund ta zërë vendin e çështjes së natyrës së vetë shkencës. Një shkencë e bazuar në një botëkuptim antiislam nuk mund të quhet islame, pa marrë parasysh se sa kujdesshëm zbatohet ajo nga aspekti i normave të etikës islame. Çështja e karakterit islam kryesisht ka të bëjë me llojin e diturisë, parimet, menytë, metodat, mjetet dhe qëllimet të cilat e përbëjnë shkencën në fjalë. Për këtë arsye, drejtpërsëdrejti duhet të ndeshemi me lëndën e asaj që e përbën shkencën islame ose me veçoritë që duhet t'i posedojë një shkencë për t'u quajtur islame.

Fillimisht, një shkencë e denjë për t'u quajtur islame duhet ta reflektojë Njëjësinë (Tewhidin) dhe duhet të shpiejë drejt saj. Ajo s'guxon ta fshehë ndërlidhjen e gjësëndeve e cila e përbën reflektimin e nivelit të shumëllojshmërisë së njësisë (unitetit), përkundrazi, ajo duhet ta theksojë dhe ta nxjerrë në pah këtë. Ajo s'guxon ta ndajë natyrën në pjesë duke u mbështetur vetëm në një pikëpamje analitike pa sintezën përcjellëse. Ajo kurrsesi s'guxon që një fushë të caktuar të realitetit me të cilën ka të bëjë ta konsiderojë si plotësisht të pavarur nga fushat e tjera të tij, po as edhe ta mospërfillë të tërësishmen për shkak të pjesërishmes. Ajo natyrisht se mund ta studiojë një pjesë, për shembull, një mineral të caktuar, një bimë, një kafshë, një pjesëz nënatomike, apo edhe një galaktikë të tërë, por skeleti dhe korniza gjithmonë duhet të jetë e tërësishmja, gjegjësisht, tërësia e realitetit kozmik, e cila e reflekton parimin e Njëjësisë si në të tërën ashtu edhe në pjesët e tij, një reflektim ky i cili nuk mund të hetohet ndryshe vetëm se me të qenët i vetëdijshëm për të tërësishmen, për të cilën në mënyrë ontologjike janë të lidhura pjesët e saj.

Tewhidi, gjithashtu duhet të reflektohet në çdo shkencë islame përmes vetëdijes për Tewhidin si parim hyjnor, e jo vetëm si parim i integritetit dhe i ndërlidhjes. Asnjë shkencë nuk mund të quhet islame përderisa pretendon ta studiojë atë që është e krijuar duke mos ia përshkruar këtë Zotit dhe duke e përjashtuar Krijuesin nga këndshikimi i saj lidhur me realitetin. Nuk lejohet që natyra të studiohet ndashëm prej Mjeshtrit (*es-Sāni*) i Cili e ka krijuar dhe ia ka dhënë formën e lëvizjen. Shkenca e cila pretendon të jetë islame duhet të merret me kozmosin si krijesë të Zotit, të cilin e mbështet dhe e furnizon Ai dhe i cili më në fund do t'i kthehet prapë Atij. Kjo shkencë duhet ta studiojë kozmosin e këtillë nga aspekti i njohjes të bazuar në Zotin dhe e cila Diturinë hyjnore e posedon si pikë referimi final të saj. Perëndia ose Zoti Një (*el-Ehad*) duhet të jetë alfa dhe omega e shkencës islame, ndërkaq studimi dhe hulumtimi i ndërlidhjes së të gjitha qenieve dhe i rendeve të realitetit kozmik duhet të jetë caku dhe qëllimi më imediat dhe më i drejtpërdrejtë i saj.

Harmonia është rezultat dhe reflektim i Njëjësisë në botën e shumëllojshmërisë. Po kështu, një shkencë e bazuar në Tewhid, si në parimet e saj ontologjike ashtu edhe në ato intelektuale, brenda vetes duhet të posedojë një harmoni dhe përshtatje të plotë. Forma dhe përmbajtja e kësaj shkence duhet ta reflektojë harmoninë e cila e përshkon tërë këtë kozmos. Kur shkencëtarët muslimanë flisnin për rendin e universit si *Nidhāmu 'l-Ālem*, ata kishin për qëllim pikërisht këtë harmoni të cilën u munduan ta paraqisnin në studimet

e tyre lidhur me rendin e krijuar dhe këtë ta bënin lëndë hulumtimi të shkencave të tyre.<sup>3</sup> Kjo shkencë mund të jetë fushë interesimi e të shtrihet prej shkencës së biologjisë e deri te matematika, mirëpo çështja e harmonisë kudo mbetet qendrore. Interesimi i disa fizicientëve të matematikës të këtij shekulli për simetrinë dhe bukurinë matematikore të cilën e konsiderojnë gati si argument shkencor,<sup>4</sup> përfaqëson një filozofi të përngjashme me këtë aspekt të shkencës islame, duke e përjashtuar me këtë rast faktin se shkenca islame në mënyrë të pandryshueshme e të vazhdueshme e lidh këtë harmoni dhe bukuri matematikore me Bukurinë e Zotit dhe se në këtë harmoni ajo i sheh gjurmët e urtësisë së Krijuesit.<sup>5</sup>

Shkenca islame, gjithashtu duhet t'i përgjigjet realitetit, gjegjësisht ajo duhet të shpiejë drejt njohjes së disa aspekteve të rendit objektiv të realitetit dhe t'i zbulojë e t'i shpjegojë ato. Kjo kërkesë mund t'i duket fare e qartë atij që mendon për fjalën arabe *el-'ilm* ashtu siç përdoret dhe zbatohet në gjuhën e natyrshme arabe. Kur shkenca të mendohet e të kuptohet si *el-'ilm*, atëherë ajo nuk do të mund të ndahej nga *el-hakīkah* (e vërteta), sepse atëherë më nuk do të ishte *'ilm* i vërtetë. Përveç kësaj, vetë termi *el-hakīkah* është i pandashëm nga ideja e realitetit dhe, në fakt, në gjuhën klasike arabe me të mund të nënkuptoheshin të dyja: edhe e vërteta edhe realiteti. Për këtë arsye, në kokën e muslimanit shkenca është e ndërlidhur ngushtë me realitetin dhe është shumë vështirë që të nënkuptohet ndryshe nga se ç'është.

Megjithkëtë, çdokush që është i njoftuar me historinë e shkencës dhe të filozofisë perëndimore e di se astronomët matematikanë grekë, siç ka qenë Ptolomeu, kanë besuar se roli dhe detyra e modeleve matematikore për shpjegimin e lëvizjes së planeteve duhet të jetë "ruajtja e dukurisë" e jo t'i përgjigjet realitetit të sferave të ndryshme qiellore që shërbejnë për shpjegimin e lëvizjes planetare. Ai që shkroi për natyrën fizike të këyre sferave të nënkuptuara si matematikore dhe për domosdoshmërinë e përshtatjes së modelit matematikor me realitetin fizik, qe shkencëtari musliman Ibni Hejthemi. Paskëtaj, qëllimi i shkencës për ta zbuluar natyrën e realitetit fizik u bë pjesë e pandashme e botëkuptimit shkencor perëndimor,<sup>6</sup> përderisa në fizikën moderne ky qëllim përsëri u la mënjanë nga shumë filozofë të shkencës të cilët konsideronin se modelet fizike më mirë është që t'u

<sup>3</sup> Duhet përkujtuar se në gjuhën arabe fjala *nadhīm* gjithashtu nënkupton edhe poezinë apo harmoninë e zërave.

<sup>4</sup> Disa zhvillime të mëdha në fushën e fizikës moderne, siç janë zbulimet e Broglie-t dhe të Dirac-ut, në të vërtetë, mbështeten në argumentet e domosdoshmërisë së simetrisë, elegancës, harmonisë..matematikore, e natyrisht se jo në vërtetimet empirike.

<sup>5</sup> Ky aspekt i shkencës islame në masë të madhe i shëmbëllen traditës Pitagoriano-Platonike të cilën Islami e integroi aq lehtë dhe me përpikshmëri në botëkuptimin e tij, ngase kjo ishte një urtësi e bazuar në Njëjësinë dhe harmoninë ndaj dhe e afërt me botëkuptimin islam, e nuk ishte shkaku i tij. Shih S. H. Nasr, *An Introduction to Islamic Cosmological Doctrines*, Londër, 1978, f. 44 e më tej.

Prezenca e një doktrine të caktuar në dy shkolla të mendimit, qoftë ajo shkencore apo e ndonjë llojit tjetër, nuk nënkupton domosdoshëm ndonjë huazim historik apo ngjashmërinë e të dyja shkollave. Në rastin e shkollave tradicionale, ku shumica janë të bazuara në një koncept të shenjtë mbi diturinë dhe kozmosin, krahasimi me shkencën moderne e cila mund të përmbajë disa elemente të përngjashme me shkencën islame, ashtu si u ilustrua edhe më lartë, por e cila posedon një kornizë, një qëllim dhe metoda krejtësisht të ndryshme nga ato të shkencës islame, gjithsesi se është i mundshëm. Shih S. H. Nasr, "The Role of the Traditional Sciences in the Encounter of Religion and Science: An Oriental Perspective", në *Religious Studies*, vëll. XX, dhjetor 1984, f. 519 – 541.

<sup>6</sup> Edhe pse kjo pikë është diskutuar, sipas mendimit tim, fakti që shkenca perëndimore e Mesjetës dhe pas saj, po madje edhe gjatë Revolucionit shkencor e deri në shek. XX, qëllimin e shkencës e ka konsideruar, natyrisht, si zbulim të natyrës së realitetit fizik, ka qenë rezultat i ndikimit të shkencës islame.

përshtaten llogaritjeve matematikore të cilat u përgjigjen dukurive të dukshme se sa t'i përgjigjen në mënyrë të domosdoshme natyrës së asaj që studiohet. Për këtë arsye, asnjë shkencë, modelet përmes të cilave i shpjegon gjërat, nuk i identifikon në mënyrë të domosdoshme me natyrën e realitetit dhe shumë shkolla të filozofisë së shkencës në Perëndim, të cilat në këtë apo në ndonjë formë tjetër janë të bazuara në pozitivizëm, do ta kundërshtonin në tërësi një identifikim të këtillë.

Ndërkaq në shkencën islame patjetër duhet të ekzistojë kjo lidhje midis shkencës dhe realitetit.<sup>7</sup> Shkenca duhet t'u përgjigjet disa aspekteve apo anëve ontologjike të lëndës që studion. Ajo s'mund të kënaqet vetëm me modelet matematikore të cilat mund t'i parashohin gjërat dhe t'i përshkruajnë dukuritë e të cilat nuk i përgjigjen realitetit fizik. Qëllimi i çdo shkence e cila do të mund të karakterizohej si islame duhet të jetë studimi i natyrës së gjërave ose i disa niveleve të realitetit në kuptimin e tij ontologjik e jo vetëm studimi i aksidencave dhe i dukurive (fenomeneve) ndashëm nga substanca dhe noumeni. Meqë qëllimi i kësaj shkence është Njëshi (Tewhidi), ajo duhet të jetë e gatshme t'i njohë disa aspekte të një rendi të caktuar të realitetit si përfundimisht të lidhur me Realitetin ose me Parimin hyjnor dhe se nuk duhet të mbetet e kënaqur me përshkrimet matematikore të cilat, pa marrë parasysh se sa janë efikase në udhëheqjen dhe drejtimin e forcës e të dukurive të natyrës ose në parashikimin e gjërave, nuk i përgjigjen natyrës së botës si krijesë e Zotit dhe të cilat, si rrjedhojë e kësaj, nuk mund ta plotësojnë definimin themelor të diturisë ose të *el-‘ilmit* siç do të kishim thënë nga aspekti islam.

Universi islam është i renditur në mënyrë hierarkike dhe asnjë shkencë nuk mund të quhet islame në qoftë se nuk e merr në konsiderim realitetin e kësaj hierarkie. Kur'ani i ndershëm nuk flet vetëm për qenësinë (*dhāt*), emrat dhe cilësitë e Zotit, por në të gjithashtu përmenden dhe bëhet fjalë edhe për shirtin (*el-rūh*), për melekët, xhinnët, njerëzit, qiejt e tokën. Në të shpesh cekën edhe shkallët dhe shtresat e njerëzve, siç thuhet në ajetin "*Ai është që ju bëri sundues (zëvendësues) në tokë dhe lartësoi në një shkallë më të lartë disa nga ju mbi të tjerët...*", (El-En'am, 165) dhe përmend se bota shpirtërore është më e lartë nga ajo materiale (fizike) siç thuhet në ajetin "*Shiko se si ne i kemi dalluar disa prej të tjerëve, po dallimi në botën tjetër, pa dyshim, është më i madh dhe është përparësi më e madhe*", (El-Isra', 21). Po kështu, edhe në mjaft Hadithe shpesh përmenden pozitat dhe nivelet e melekëve që i përfshijnë shkallët e realitetit të cilat ekzistojnë midis Zotit dhe botës fizike (materiale) në të cilën jeton njeriu. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Krijuesin dhe të krijuarën, por edhe për nivelet e mesme të realitetit duke nisur që nga shpirti (*el-rūh*) i cili sipas Kur'anit është "*urdhër (çështje) që i përket vetëm Zotit tim*", (El-Isra', 85) dhe i cili e kaplon qendrën e kozmosit, e deri te (katër) melekët e mëdhenj, melekët e rëndomtë, forcat psikike dhe përfundimisht deri te bota e dukshme e cila është e përbërë nga një sërë nivelesh (shtresash).

Po kështu, në shumë Hadithe flitet për "shtatëdhjetë mijë perdet e dritës e të errësirës" dhe për një numër të madh të shtresave të dritës e cila duke iu afruar në mënyrë graduale

---

<sup>7</sup> Kjo, përgjithësisht është e vërtetë për të gjitha shkencat tradicionale. Shih F. Brunner, *Science et réalité*, Paris, 1955.

rrafshit fizik bëhet gjithnjë e më e zbehtë.<sup>8</sup> Në mendimin islam hierarkia në krijesën e Zotit zë një vend aq qendror saqë në shumë tekste tradicionale ata që e kanë mohuar hierarkinë e ekzistencave (*merātibu'l-wuxhūd*) janë konsideruar si të pafe ose heretikë (*zindik*). E gjithë shkenca tradicionale islame është bazuar në një kozmologji që kujdeset për natyrën hierarkike të realitetit kozmik e cila e përbën lëndën e çdo shkence natyrore.

Hierarkia ekziston edhe në subjektin i cili e studion rendin objektiv. Nivelet e realitetit nuk janë të vetmet që duhen studiuar, por kjo duhet bërë edhe me nivelet e vetëdijes ose me llojet e njohjes që kanë një natyrë hierarkike dhe që janë të afta për ta studiuar këtë realitet objektiv. Kështu, Kur'ani flet edhe për nivelet e shpirtit duke e përfshirë këtu *ennefsu'l-emmāren, lewwāmen, mutma'innen, rādijjen* dhe *merdijjen*.<sup>9</sup> Po kështu, Kur'ani flet edhe për nivelet e atyre që dijnë dhe atyre që s'dijnë, e për më tepër bën dallimin midis atyre që janë "të thelluar në dituri" (*er-rasihun fi'l-'ilm*) dhe dijetarëve të rëndomtë. Ngjashëm me këtë edhe në literaturën e Hadithit hasim njohuri lidhur me nivelet e diturisë e të vetëdijes apo me hierarkinë e llojeve të njohjes.

Mbi këtë bazë të shpallur (nga Zoti), shkenca dhe filozofia islame u zhvilluan në mënyrë që do ta theksonin hierarkinë si në fushat subjektive ashtu edhe në ato objektive. Të gjitha klasifikimet e shkencave, aq të rëndësishme për shkencëtarët muslimanë duke nisur që nga el-Kindiu e deri te Nasiruddin et-Tusiu dhe Kutbuddin esh-Shiraziu e duke vazhduar edhe ndër mendimtarët e kohëve më të reja, janë bazuar në këtë hierarki. Asnjë shkencë nuk mund të pretendojë të jetë islame përderisa universin material shikon ta studiojë në mënyrë të pavarur nga nivelet më të larta të ekzistencës dhe duke e konsideruar atë sikur të ishte një rend i pavarur i realitetit. Po kështu nuk mund të jetë islame një shkencë e cila nuk arrinë t'i kuptojë (dallojë) nivelet e vetëdijes dhe të llojeve të njohjes. Ta zgjerosh botën fizike nga toka e deri në qiej, po madje edhe deri te galaktika më e largët, nuk do të thotë se e ke përfshirë tërë kozmosin. E krijuara përbëhet nga nivele që nuk janë të natyrës materiale, por të cilat domosdo duhet të merren në konsiderim në çdo shkencë të përgjithshme e cila ka të bëjë me kozmosin. Një shkencë islame e cila ka të bëjë me një rend të caktuar fizik të realitetit gjithsesi se është e mundshme të ekzistojë, përderisa i shërben një kozmologjie e cila kujdeset për nivelet e ekzistencës universale. Për këtë arsye, një shkencë e këtillë do t'i takojë një hierarkie të diturisë e cila në suazat e saj do të mund ta inkorporonte një shkencë të tillë. Por, kjo është e mundshme vetëm nëse kjo shkencë e ruan lidhshmërinë e saj me strukturën hierarkike si të polit objektiv ashtu edhe të atij subjektiv të realitetit.<sup>10</sup> Nuk mund të ketë shkencë islame pa hierarki, pa marrë parasysh se sa pohime fetare shtron ajo gjatë studimit të natyrës si krijesë të Zotit.

Përveç kësaj, vetë ky realiteti i hierarkisë së diturisë dhe të kozmosit është ai i cili kërkon që çdo formë e shkencës islame t'u mbetet besnike kushteve dhe kufijve të vet dhe të mos kërkojë reduktimin në nivelin e vet të asaj që qëndron mbi dhe përtej saj. Reduksionizmi,

<sup>8</sup> Disa Hadithe flasin për shtatë, disa për shtatëdhjetë e disa për shtatëdhjetë mijë perde të dritës e të errësirës. Ibn Arabi, *El-Futuhatu'l-Mekkijeh*, vëll. II, Bejrut, pa vit botimi, f. 110-131. Ose Ibn Ethir, *En-Nihajeh*, vëll. II, Kajro, f. 141. Mulla Muhsin Fajd Kashani këto perde i ka rezimuar në *El-Wafi-un* e tij, Teheran, vëll. I, f. 89.

<sup>9</sup> Shih Kur'ani (Jusuf, 53), (El-Beled, 2), (El-Fexhr, 27). Duke u bazuar në këtë mësim janë shkruar një numër trajtesash (studimesh) për ta elaboruar këtë mësim qendror lidhur me shkallët e përkryerjes së shpirtit i cili në të njëjtën kohë nënkupton edhe pozitat më të larta të vetëdijes dhe shkallët më të larta të njohjes.

<sup>10</sup> Shih S. H. Nasr, *An Introduction to Islamic Cosmological Doctrines*, në Parathënie.

që paraqet tendencën më të rrezikshme të shkencës moderne, nuk ka vend në kështjellën (sistemin) e arsimit islam. Dituria e Zotit lidhur me çdo qenie është më e përsosura dhe të gjitha dituritë duhet t'i nënshtrohen asaj. Megjithkëtë, në nivelin njerëzor ka një sërë shkencash të cilat janë të mundshme në një rend të vetëm të realitetit, njësoj si në shkencën moderne ku një bimë mund të studiohet nga aspekti ekologjik, botanik, biologjik, kimik dhe fizik. Mirëpo, në shkencën moderne apo më mirë thënë në botëkuptimin që e përcakton këtë shkencë, ekziston një tendencë thuajse e fshehtë që dëshiron reduktimin e dukurive të gjalla në kimi, ndërsa kiminë në fizikë. Në shkencën islame një reduksionizëm i këtillë do të ishte absurd, sepse realiteti final i një objekti nuk është aspekti fizik i tij, por kjo është dituria e Zotit lidhur me këtë objekt dhe se rrënja e sendi qëndron në dorën e Zotit (*"Thuaj: Në dorën e kujt është i tërë pushteti i çdo sendi...?"*, (El-Mu'minūn, 88). Një nivel më i ulët mund të studiohet në dritën e një më të lartit, por kurrë s'mund të ndodhë e kundërta (*vice versa*). Një shkencë e kultivuar në një univers ku dominon ideja e hierarkisë nuk mund të jetë reduksioniste dhe asgjë nuk ka më të kundërt me botëkuptimin islam se një reduksionizëm i cili shpirtin e redukton në psikë, psikën në aktivitet biologjik, jetën në procese kimike dhe këto procese në forca e interaksione pastër fizike. Shkenca islame, përkundrazi, posedon pikën e vet të referimit në Rendin hyjnor i cili është burimi i hierarkisë në të cilën çdo shkallë më e lartë e qenies paraqet parimin (bazën) e më të ultës dhe e cila nuk mund të reduktohet në të.

Në universin hierarkik në të cilin, si çdo gjë tjetër islame, jeton dhe vepron shkenca islame, kozmosi ka një qëllim siç e ka edhe shkenca e cila e studion atë. Zoti nuk e ka krijuar këtë botë më kot, siç përmend edhe Kur'ani *"Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot"*, (Ālu Imran, 191). Për më tepër, sipas një hadithi kudsijj mjaft të njohur krijimi i botës ka një qëllim: *"Isha një thesar i fshehtë dhe desha që të njihem, andaj e krijova botën (el-'ālem) me qëllim që të njihem"*. Prandaj qëllimi i krijimit të botës është "Njohja e krijesave Zotin e tyre". Të gjitha lëvizjet në kozmos veprojnë dhe ndodhin sipas këtij qëllimi suprem si synim i tyre, qëllim ky i cili arrihet përmes njohjes dhe vetëdijësimit të njeriut për hyjnoren.<sup>11</sup> Kozmosi islam është i orientuar drejt një qëllimi. Ai ka një cak, një qëllim, një *teleos* dhe perspektiva kozmologjike e tij është teleologjike. Çdo shkencë që ka për qëllim studimin e një universi të këtillë duhet të jetë edhe teleologjike, përkundër (të kuptuarit të) shkencës post-kopernikane në Perëndim e cila ngulshëm refuzoi ekzistimin e çfarëdo lloji elementesh dhe idesh teleologjike në shkencë. Shkenca islame duhet të ketë një qëllim jashtë vetes. Ajo s'mund të funksionojë për shkencën në emër të shkencës. Qëllimi më i lartë i saj duhet të jetë ai që t'i ndihmojë njeriut në arritjen e asaj supremes dhe për të cilën është krijuar kozmosi dhe, së këndejmi, ta tregojë një shkencë më të lartë jashtë vetes duke e shpënë përfundimisht te "shkenca supreme" (*el-'ilm el-a'lā*) e që është shkenca e Zotit, ose duhet t'i dalë në ndihmë njeriut në nevojat e tij të kësaj bote si p.sh. në fushën e mjekësisë e të bujqësisë. Shkenca islame nuk është utilitariste në kuptimin modern të fjalës, por ajo i kënaq nevojat e njeriut të cilat në radhë të parë vijnë ato shpirtërore e pastaj ato materiale. Sido që të jetë, një shkencë që pretendon të quhet islame, duhet të jetë teleologjike, sipas asaj se duhet të ketë

<sup>11</sup> Është mjaft për t'u habitur se disa fizicientë bashkëkohorë i janë kthyer idesë teleologjike duke pohuar se duket që kozmosi ka një qëllim e që është prezenca e vetëdijes dhe se kjo vetëdije vetvetiu luan rol në shpalimin e historisë së kozmosit.

marrëdhënie edhe me teleosin e kozmosit edhe me atë të njeriut, funksioni më i lartë i të cilit është të veprojë si mjet përmes të cilit Zoti e prezenton Vetveten në krijesën e Tij. Meqë bota ka një qëllim dhe një cak, edhe shkencë e cila pretendon ta studiojë atë duhet të ketë një qëllim i cili s'mund të jetë gjë tjetër pos Zotit, edhe pse disa shkencë mund të vazhdojnë të mbeten të lidhura vetëm me një aspekt të kufizuar të veprës së Zotit.

Një shkencë islame, për të luajtur një rol të këtillë, në asnjë fushë të sajën dhe asnjëherë nuk mund ta ndajë mjetin e njohjes nga e shenja. Nuk ekziston asnjë fushë e përshtatshme për studimin e shkencës e cila në vete është profane. Shkencë profane është krijuar nga botëkuptimi profan përmes të cilit studiohet fusha në fjalë. Në Islam, subjekti që studion dhe njeh, pra arsyeja (*el-'akl*), kurrsesi nuk mund të ndahet nga e shenja (sakralja) dhe nga drita e Shpalljes.<sup>12</sup> Një libër i algjebërës apo i mineralogjisë i shkruar nga një shkencëtar musliman mund të duket i ngjashëm me ndonjë libër shkencor modern që ka të bëjë me këto lëmi. Miëpo, një studim më i përafërt do të tregojë se ekziston një dallim i madh midis këtyre dyve. I pari akoma i takon një bote në të cilën e shenja dhe profanja nuk janë të ndara dhe ku në të vërtetë profanja nuk njihet si një rend i pavarur i realitetit; ndërkaq i dyti është fryt i një mënyre të menduarit që e ndanë plotësisht të shenjtën nga profanja apo sekularja dhe që insiston në natyrën sekulare të të gjitha shkencave. Prandaj, shkencë islame nuk mund të jetë islame përveç nëse mbetet brenda asaj bote të shenjtës, të krijuar nga Shpallja Kur'anore, një botë në të cilën mjeti i njohjes nuk e humb kurrë lidhjen e vet me të shenjtën dhe ku çdo formë e diturisë, madje edhe shkencë e botës materiale, është e mbushur me ndjenjën e së shenjtës.

Duhet përkujtuar se ruajtja e karakterit të shenjtë të diturisë është e lidhur ngushtë me pikëpamjen e përgjithshme të "realitetit" të brendshëm dhe të jashtëm, i cili përfundimisht paraqitet si pasojë e mësimin të Tawhidit (Njëjesisë). Shkencë islame nuk mund të veprojë në një botë në të cilën një aftësi e caktuar e subjektit njohës, apo një fushë e realitetit, ndodhet plotësisht e ndarë nga fushat e tjera dhe përfundimisht nga Njëshi i cili është burimi i tërë ekzistencës objektive dhe në kuptimin e fundit e ndarë edhe nga i Dituri, sepse Zoti, siç thekson edhe Kur'ani i madhërishëm, është *el-'Alīm* (dituria e të Cilit kaplon çdo gjë). Secila shkencë legjitimisht mund të merret me një rend të caktuar të realitetit, si p.sh. me bimët, me kafshët ose me yjet; në fakt shkencat tradicionale islame edhe kanë insistuar në përcaktimin e kufijve të çdo një shkence dhe të lëmvive brenda të cilave mund të aplikohen ato, siç kanë insistuar edhe për metodat e përshtatshme të çdo shkence,<sup>13</sup> mirëpo ky insistim nuk nënkupton pjesëtimin përfundimtar të realitetit ose të degëve të shkencës. Përkundrazi, ky insistim në definimin e lëmisë së çdo shkence ka për qëllim ikjen nga çdo lloj i reduksionizmit dhe ruajtjen e asaj hierarkie përmes së cilës vetvetiu ruhet dominimi i njëjesisë (unitetit) mbi shumësinë (multiplicitetin).

---

<sup>12</sup> Shih S. H. Nasr, *Knowledge and the Sacred*.

<sup>13</sup> Ky insistim i Islamit lidhur me kufizimin e çdo shkence dhe të fushës së aplikueshmërisë së saj, është vendimtar dhe vital kur është në pyetje çështja e integritetit të shkencave në një botëkuptim me natyrë religjioze. Përmes këtij insistimi lidhur me kufijtë e çdonjë shkence dhe me metodat e përshtatshme me të si dhe përmes refuzimit të përzierjes së metodave dhe të qasjeve (*haltu 'l-mebhath*), Islami e ka penguar këtë përgjithësim të një shkence të një rendi material që do ta përfshinte tërë realitetin, përgjithësim ky i cili gjendet në trajtat e ndryshme të sciantizmit apo të "filozofisë së shkencës" në botën moderne e që shtrihet prej pozitivizmit e deri te marksizmi.

Po kështu, edhe pse në fillim të çdo shkence islame të mësuar në mënyrë tradicionale, metoda apo metodat që janë përdorur në këtë shkencë janë diskutuar gjerë e gjatë dhe janë definuar qartë, Islami kurrë nuk ka insistuar se ekziston vetëm një metodë shkencore. Për fitimin e njohjes, krahas mjaft metodave të tjera, e ka përdorur edhe vrojtimin dhe induksionin, duke e përfshirë, natyrisht, edhe Shpalljen, dritën e arsyes dhe nxjerrjen e përfundimeve nga parimet me anë të intelektit. Shkenca islame në botëkuptimin e saj më të gjerë mund ta inkorporojë atë që quhet metodologji shkencore moderne, por nuk mund ta pranojë atë që sot quhet “metodë shkencore” si metodë të vetme legjitime për njohjen e botës natyrore. Në shkencat islame ekzistojnë mjaft metoda kërkimi të cilat përputhen me natyrën e lëmisë që kërkohet si dhe me natyrën e shkencës që studiohet. Shkenca islame kurrsesi nuk mund t’i gjuhëzohet scientizmit, racionalizmit dhe empirizmit përderisa mund dhe përderisa ka prodhuar shkenca të natyrës shumë më ekzakte të cilat janë racionale dhe të cilat kur merren me botën ndijore po kështu e përdorin edhe metodën empirike. Asnjë shkencë nuk mund të jetë islame, përderisa mundësinë e njohjes e kufizon vetëm me metodën empirike; ndërkq shkenca islame nuk i ik metodës empirike atje ku mund të aplikohet duke mos iu gjuhëzuar kufizimeve të ndonjë metodologjie të kufizuar e cila sipas natyrës (së vet) e këput lidhjen midis shkallëve dhe fushave të ndryshme të diturisë dhe të ekzistencës dhe me rrënimin e këtyre hierarkive e këput edhe lidhjen midis Zotit dhe krijesave të Tij, midis diturisë me karakter hyjnor dhe formave të ndryshme të diturisë njerëzore.

Edhe pse disa shkolla të teologjisë islame (*kelāmit*) i kanë mohuar të gjitha shkaqet sekondare në emër të Vullnetit të Zotit, shkencat islame kanë insistuar në rëndësinë e kauzalitetit pa të cilin, në të vërtetë, nuk do të kishte shkencë. Vetë Kur’ani i shenjtë thekson se çdo gjë në këtë botë ekziston sipas një mase e jo një mënyrë *ad hoc* (rastësisht, shkel e shko), siç thotë ajeti “*E nuk ka asnjë send që burimin mos ta ketë te Ne, po Ne, nuk e japim atë ndryshe vetëm sipas një mase të caktuar*”, (El-Hixhr, 21). Edhe pse në kelamin (teologjinë) e esh’aritëve mohimi i të gjitha shkaqeve sekondare në emër të Vullnetit të Zotit mund të kuptohet si një mundësi teologjike në historinë islame, edhe shikimi i shkencave islame i cili insiston në realitetin e shkaqeve horizontale apo sekondare duke mos e mohuar Shkakun Vertikal, është islamik në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse Zoti nuk është vetëm Vullnet, Ai është edhe Qenie, edhe Dije. Ai çdo gjëje që e ka krijuar ia ka dhuruar një natyrë të caktuar, kështu ujit ia ka dhënë natyrën e të qenët i lagur, zjarrit të jetë djegës dhe formës që të mund të ndahet më dysh.

Shkenca islame duhet ta njohë kauzalitetin (*el-esbāb* ose *el-‘ilel*) si një pjesë të botëkuptimit të saj. Në të vërtetë, sipas disa haditheve kjo botë shpesh quhet edhe “bota e shkaqeve” (*‘ālemu’l-esbāb*). Madje edhe Shpallja (*vahji*, revelata) është dërguar përmes një mjeti apo shkaku, e ai është meleku Xhebrail (a.s.). Mirëpo, zinxhiri i shkaqeve të llojit “horizontal”, assesi nuk i përbën shkaqet e vetme në shkencën islame. Sipas botëkuptimit islam gjithnjë duhet të kihet parasysh Shkaku Vertikal i cili finalisht është Vullneti i Zotit, sepse asnjë nivel i realitetit nuk mund të jetë i pavarur në vetvete, e po kështu as edhe një hallkë e kauzalitetit, siç kuptohet zakonisht, nuk mund ta kaplojë tërë fushën e një realiteti të caktuar. Përkundër shkencës moderne ku shkaqet e ndonjë dukurie kërkohen vetëm në rrafshin material apo më mirë thënë në atë psiko – fizik, shkencat islame e refuzojnë



kufizimin e shkaqeve (vetëm) në fushën në të cilën paraqitet dukuria. Gjithmonë ekzistojnë shkaqe të hapura për fushat e tjera dhe përfundimisht ekziston Shkaku i të gjitha shkaqeve ('*il-letu'l-'ilel*) që është Shkaku final, përpara të cilit të gjitha shkaqet reduktohen në asgjë, në hiç. Pa marrë parasysh nivelin e dukurisë e cila paraqet lëndën e ndonjë shkence, shkaqet sekondare mbeten reale. Në të vërtetë, edhe këto, përfundimisht, dalin nga Shkaku Suprem. Edhe në shkencën më të lartë që është ajo e Zotit thuhet se i gjithë veprimi, tekefundit, është vepër e Zotit (*fi'lull-llāh*). Megjithkëtë, në disa shkencë duhet të konfirmohen shkaqet sekondare apo horizontale, por kjo gjithnjë duhet bërë duke e patur parasysh Shkakun Vertikal, sepse këto shkencë duhet të jenë “të vetëdijshme” për prezencën e *fi'lull-llāhut* dhe të urtësisë së veprës së Tij në të gjitha shkallët e ekzistencës kozmike.

Shkenca islame duhet të insistojë në dallimin e qartë midis shkaqeve të vërteta të ngjarjeve e të dukurive dhe të shkaqeve të dukshme (*dhāhir*), siç e bën këtë në dallimin midis shkencës dhe opinionit apo midis diturisë së saktë dhe hipotezës. Natyrisht se hipoteza dhe supozimi zënë një vend të rëndësishëm në procesin e aktivitetit shkencor, siç e kanë diskutuar këtë gjerë e gjatë edhe shkencëtarët klasikë muslimanë, si p.sh. Ibni Sinai. Këto (hipoteza dhe supozimi) mund të ndihmojnë në zbulimin e shkaqeve të vërteta dhe t'i dallojnë këto nga ato të sipërfaqshmet (*dhāhir*). Mirëpo, supozimi dhe hipoteza kurrë s'guxojnë të ngatërrohen me shkencën e cila në kontekstin islam gjithnjë nënkupton sigurinë e plotë (*el-jakīn*). Në Islam ka vend “shkenca” e rendit fizik e cila “zhvillohet” nga më pak drejt më tepër ekzaktes (së përkryerës), por ky lloj i “shkencës” e cila zhvillohet nga më e njohura drejt së panjohurës, duhet t'i nënshtrohet shkencës e cila është e bazuar në sigurinë e plotë dhe e cila, sëkëndejmi, duhet ta përcaktojë “shkencën” që gjithnjë është në lëvizje (jostabile) dhe duhet ta përfshijë atë në një mënyrë e cila do të mund ta lidhte këtë “shkencë” vazhdimisht të ndryshueshme, të bazuar në hipoteza dhe në verifikimet e tyre empirike me të vërtetat permanente të Shpalljes islame.

Asnjëherë nuk duhet harruar se sipas fjalëve të Kur'anit të ndershëm, Zoti di çdo gjë që ekziston në rrafshet e realitetit që duket dhe të atij që s'duket. Çdo lloj i diturisë i takon All-llahut xh.sh. dhe kjo vetëm më ekziston në Dritën e Tij apo në Intelektin hyjnor, sepse siç thekson edhe Kur'ani “*Ai është që di të fshehtën dhe të dukshmen...*”, (Er-Ra'd, 9). Sipas botëkuptimit islam e gjithë shkenca e vërtetë (autentike) s'është gjë tjetër pos heqje e duvakut të shkencës që vetëm më është prezente “te Zoti” (*indall-llah*), e jo zbulim i diçka krejtësisht të panjohurës siç e kupton këtë shkenca moderne. Shkenca nuk mund të përbëhet as nga hipotezat thjesht të përshtashme e të shtruara për t'i shpjeguar dukuritë në një mënyrë që kënaq nga aspekti matematikor, e as nga një sistem i paramenduar për ta kontrolluar a drejtuar natyrën. Siç u përmend edhe më parë, shkenca islame nuk mund të jetë gjë tjetër veç realizim i qëllimit për të cilin është lutur Muhammedi a.s. kur thotë: *Rabbenā erinā el-eshjā'e kemā hije!* (O Zot, na i trego gjërat ashtu siç janë!).

Për më tepër se një mijë vjet Islami krijoi shkenca të cilat i përgjigjen këtij qëllimi të lartë dhe të cilat i posedojnë veçoritë që i përshkruam në këtë punim. Këto, pra, janë veçoritë permanente (të përhershme) të çdo shkence vërtet islame, sepse dalin nga burimet e pandryshueshme të vet fesë Islame. Shkencat islame mund t'i inkorporojnë zbulimet autentike të shkencës moderne dhe në të vërtetë ekziston mundësia që muslimanët të

hapin një kaptinë tjetër në historinë e gjatë të shkencës islame dhe të krijojnë shkenca të natyrës vërtet islame. Por, kjo mund të bëhet vetëm nëse veçoritë dhe karakteristikat që e veçojnë shkencën islame vazhdojnë pa prapësi të bëjnë këtë në çdo hap të hedhur për ringjalljen e traditës së gjatë të shkencës islame në përputhshmëri me natyrën e kësaj shkenca dhe me nevojat e bashkësisë apo shoqërisë islame.

**Nga anglishtja:**

**Mr. Rejhan Neziri**